



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
28.01.2020, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Valbona Petrovci, e pavarur, Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha, i pavarur dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Drilon Pireva (PSD), Valbona Ajeti (AAK), Fikneta Bejtë (e pavarur), Migjen Shala (PDK) dhe Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR).

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, drejtorët e drejtive të Komunës, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së përfaqësues të medjeve të shkruara dhe elektronike dhe Ali Sefa, përfaqësues i Grupit të qytetarëve përmbrojtjen e lisenit të Badovcit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit, i cili tha se përkëtë mbledhje është propozuar ky

## Rend i ditës:

### 1. Diskutim lidhur me çështjen e ndërtimeve në liqenin e Badovcit.

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

**Leutrim Retkoceri** tha se sot së bashku me qytetarë të Prishtinës, jemi mbledhur që të kundërshtojmë ndërtimet në liqenin e Badovcit, të mos lejojmë shkeljet ligjore dhe të mbrojmë ujin e pijshëm të qytetarëve të Prishtinës. Kjo seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për mbrojte të liqenit të Badovcit, është iniciuar nga Grupi i asamblistëve të PDK-së, dega në Prishtinë, duke pasur parasysh neglizhencën dhe mos transparencën e Komunës së Prishtinës. Ne duam t'u garantojmë se do të mbrojmë ujin e pijshëm të liqenit nga rreziku që vjen nga ndërtimet, do ta mbrojmë interesin dhe të drejtat e qytetarëve të Prishtinës, sepse ky ujë është jetik për të gjithë ne. Qëndrimet e harmonizuara mes grupeve të partive politike dhe qytetarëve të Prishtinës, do t'i paraqesë përfaqësuesi i grupit për mbrojtjen e Badovcit, dhe këto pika të propozuara do të qiten në votim.

**Agim Gashi** theksoi se kjo seancë nuk është thirrur për të bërë propagandë subjektet politike, po jemi pajtuar në parim që t'i kundërshtojmë paralajmërimet për ndërtimet afër liqenit të Badovcit, përkatësisht të ndihmojmë të zgjidhet një problem që po i brengos të gjithë. Nuk jemi takuar këtu ne të promovojmë politikat e partive politike veç e veç, por ta zgjidhim një problem që po i brengos të gjithë.

**Halim Halimi** tha se ne duhet të bisedojmë për këtë çështje, sepse është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për qytetarët e komunës së Prishtinës, që janë jashtëzakonisht të shqetësuar me paralajmërimet për ndërtimet të cilat do të bëhen në zonën e liqenit të Badovcit. Ajo zonë sipas Planin zhvillimor komunal, parashihet si zonë urbane, pra është zonë me interes të veçantë, ku kemi të bëjmë me resurse të ujit. Ne si Grup parlamentar, kërkojmë që të pezullohen ndërtimet pranë liqenit të Badovcit, derisa të nxirren dokumentet e planifikimit, si Plani zhvillimor komunal urban dhe Harta zonale.

**Vala Peshku** e përkrahu propozimin, që përfaqësuesi i Grupit të qytetarëve për mbrojtjen e liqenit të Badovcit, t'i paraqesë propozimet e këtij grupi.

**Eman Rahmani** tha se ne paraprakisht jemi pajtuar, subjektit PDK, LDK dhe LVV, që këto pika të paraqiten jo prej nesh, me qëllim që mos të politizohen, por të vijnë prej Grupit të qytetarëve për mbrojtjen e Badovcit.

**Bukuriye Canolli** tha se ne si Grup parlamentar jemi kundër çfarëdo lloj ndërtimi në afërsi të liqenit të Badovcit.

**Sami Boroci** u shpreh se ne patjetër duhet ta trajtojmë këtë çështje me dhënien e një epilog në të mirë të qytetareve të Prishtinës. Pajtohem që ndonjëri në emër të qytetarëve t'i paraqesë ato pika, pastaj ne të diskutojmë për përbajtjen e tyre dhe qëndrimin tonë lidhur me këtë pikë.

**Ali Sefa**, përfaqësues i Grupit të qytetarëve për mbrojtjen e Badovcit, në emër të këtij gruji propozoi këto tre pika:

1. Anulimin e Vendimit të Komunës së Prishtinës për caktimin e kushteve ndërtimore, të datës 26.12.2019;
2. Pezullimin e të gjitha vendimeve, kushteve ndërtimore, lejeve ndërtimore në zonën e parë, të dytë dhe të tretë, deri në nxjerrjen e dokumenteve të reja të planifikimit hapësinor, Hartës zonale, Planit zhvillimor komunal dhe Planit rregullues;
3. Fillimin e procedurave për shpalljen e zonave përreth liqenit "Peizazh i mbrojtjes në natyrë" dhe bashkimin e tyre me Gërmimin, dhe në vendime të specifikohet, kur bëhet kërkesa nga Ministria, të kërkohet që ajo zonë të jetë zonë e gjelbër dhe të mos ketë ndërtim.

**Egzon Azemi** tha se ky projekt duhet të marrë fund sot, dhe se Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti, fillimi sht duhet ta tërheqë vendimin për dhënien e këtyre kushteve, e më pas të na japë arsyetimin e tij dhe të na tregojë se a e dinte ku po jepen këto kushte. Po ashtu, kërkoi nga z. Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikim Strategik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe nga z. Ardi Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, që të njoftojnë se a ishin të informuar se ku u dhanë këto kushte. Ai kërkoi tërheqjen e Vendimit për dhënien e kushteve ndërtimore.

**Shefki Gashi** u shpreh se nga Administrata e Komunës nuk u dha asnjë arsyetim për dhënien e kushteve ndërtimore, pra në çka është bazuar, çfarë dokumente ka lëshuar Ministria e të tjera, dhe pse ka ardhur deri këtu.

Sa i përket shqetësimit të qytetareve i përkrahim ata, është shqetësim normal, mirëpo një shqetësim tjetër shumë i madh, të cilin tash e 6 vjet e themi ne këtu dhe nuk doli asnjë grup qytetarë për ta ngritë këtë shqetësim, kur e dimë që 26 vendbanime në komunën e Prishtinës janë sot pa pikë uji. Kjo çështje që po ngrihet tani, mendoj se nuk është shtruar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ai kërkoi që kjo çështje të sqarohet në aspektin procedural.

**Arbër Vokrri** theksoi se liqeni i Badovcit është një liqe akumulues dhe afër tij nuk lejohet të bëhen ndërtimet. Si shembull konkret ai ceku liqenet të disa shteteve të Evropës, ku në afërsi të këtyre liqeneve akumuluese nuk lejohet të bëhen ndërtime. Specifisht një ndërtim i një lagjeje sikur kjo në rastin e Badovcit, nuk do të lejohej në Zvicër.

**Agim Gashi** tha se ne po propozojmë pezullimin e përkohshëm të kushteve ndërtimore, deri në harmonizimin e planeve rregulluese dhe ligjet të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Liqeni i Badovcit është pasuri në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, përkatesisht ministrisë përkatëse, dhe Komuna ka kompetenca provizore në atë përqindje të vogël sa e ka, dhe të bëjë përpjekje që ta marrë për barrë në zbatueshmëri. Ne duhet t'i rekomandojmë Qeverisë, nëse ka hapësirë ligjore, pezullimin e kushteve urbanistike deri në harmonizimin e dokumenteve që rregullojnë fushën përkatëse, sepse askush nuk mund të na ndalojë që ne ta marrim atë vendim.

**Eman Rahmani** kërkoi që menjëherë të anulohen kushtet e ndërtimit nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtori i Urbanizmit, si nënshkrues i këtyre kushteve ndërtimore; Të merret vendim i Kuvendit për pezullimin e Planit zhvillimor komunal, Planit zhvillimor urban, për atë pjesë, deri në hartimin e Planit të ri zhvillimor komunal, Hartës zonale dhe Planit të hollësishëm rregullues. Gjithashtu, zona përreth liqenit të shpallet zonë me interes të veçantë publik.

**Suzan Kika** tha se rrezikimi i Badovcit nga ndërtimet është vetëm një segment i rrezikimit për jetën e qytetarëve, prandaj liqeni akumulues i Badovcit e ka rëndësinë e vet. Konsideroj si të drejtë shqetësimin e qytetarëve, me këto shqetësime reale dhe serioze. Me qenë se kemi të bëjmë me kryeqytet, problemi të kalojë në nivel qendror, të shpallet zonë me interes të veçantë publik, në mënyrë që të mos dëmtohen pronarët, të marrin ata shpronësimet e merituara dhe të bëhet një zonë e pyllëzuar.

*Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që t'i harmonizojnë qëndrimet dhe t'i qesin para Kuvendit për miratim.*

**Leutrim Retkoceri**, në emër të grupeve parlamentare, paraqiti dy rekomandime të harmonizuara dhe një propozimvendim nga grupet parlamentare për mbrojtjen e liqenit të Badovcit:

1. Komuna e Prishtinës, në bazë të akteve ligjore në fuqi, të anulojë kushtet ndërtimore të lëshuara në pjesën e Liqenit të Badovcit, më 26.11.2019;
2. Të fillojnë procedurat, që zonën përreth liqenit të Badovcit, e cila nuk është e përfshirë në "Peizazh të mbrojtur", të bashkohet me Peizazhin e mbrojtur me parkun regional "Gërmisë";
3. Propozimvendimi për pezullimin e Planin zhvillimor komunal për zonën 1,2 dhe 3, për mbrojtjen në pjesën e Badovcit, deri në nxjerrjen e dokumenteve të reja të planifikimit në këtë zonë, Planin zhvillimor komunal, Hartën zonale dhe Planin e hollësishëm rregullues.

**Nol Nushi** bëri të ditur se ai do t'i votojë këto rekomandime, mirëpo vendimin që do ta marrë Komuna për pezullimin e Planit zhvillimor në atë pjesë, absolutisht nuk e ndal asnjë ndërtim në atë zonë, sepse deri në planin e ri plani aktual mbetet në fuqi.

**Vlora Dumoshi** theksoi se përderisa u pajtuan grupet parlamentare për harmonizimin e qëndrimeve të tyre, tash mbetet që këto rekomandime të qiten në votim dhe konsideroj se çdo diskutim i mëtejmë është i panevojshëm.

**Vala Peshku** ngriti shqetësim, duke thënë se nëse i votojmë këto rekomandime, nuk jemi duke bërë asgjë, as nuk jemi duke e mbrojtur, dhe këtu po tregohet mos serioziteti për Badovcin pikërisht prej neve. Nëse sinqerisht dëshirojmë me e mbrojtur jo vetëm Badovcin, por secilën pjesë të gjelbër të këtij vendi, atëherë ne duhet të jem më të vëmendshëm në marrjen e vendimeve të tillë.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se po votohet diçka që nuk ka efekt ligjor, atëherë nuk e di pse ne duhet me votuar, edhe unë po e votoj këtë, pavarësisht që po e di se nuk ka me prodhuar ndonjë efekt. Prandaj sa i përket çështjes së ujit, nuk besoj që kjo temë duhet me u trajtuar në këtë mënyrë, qysh e kemi trajtuar ne sot, sepse nuk po bëjmë asgjë dhe as nuk kemi me ndalur atë ndërtim.

**Kushtirm Sopa** kerkoi te dije se cila eshtë masa që e parandalon pezullim e ndërtimit përreth liqenit të Badovcit.

**Hafiz Krasniqi** theksoi se duke pasur parasysh çeshtjen e kësaj teme, thirrja më e lehtë do të ishte që të pezullohen për momentin ato kushte të ndërtimit. T'i bëhet thirrje edhe investitorit, që duke e parë situatën e krijuar, të mos krijojë skena apo mënyra të caktuara, të cilat kish me i vënë në lajthitje edhe Kuvendin e Komunës edhe ekzekutivin, por edhe atë si investitor. E përkrahim pezullimin dhe kerkoj që të bëjmë pezullimin e përkohshëm të kushteve ndërtimore.

**Shefqet Osmani** tha se vendimet e Kuvendit të Komunës janë të plotfuqishme dhe e obligojnë ekzekutivin që ato me i dërguar në ministrinë përkatëse për vlerësim të ligjshmërisë.

**Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti**, theksoi se ne dy herë e kemi refuzuar palën për dhënien e kushteve ndërtimore, dhe pas refuzimit të dytë ka ardhur edhe vendimi i shkalles së dytë. Ne iu kemi drejtuar edhe gjykatës dhe kemi iniciuar padi për konflikt administrativ, por padia për konflikt administrativ nuk na liron nga përgjegjësia që të zbatojmë vendimin. Pra, Ministria vendos për këtë çështje dhe kushtet nuk vlejnë nëse nuk ka pëlqim mjedisor. Pala nuk ka aplikuar fare për leje, prandaj po e them që kjo ka mundur me u trajtuar edhe në mbledhje të rregullt.

Unë, si Kryetar i Komunës, i ftoj të gjithë asamblistët, që në mënyrë ligjore t'i ndalin të gjitha ndërtimet rreth Badovcit, në qoftë se ka, sepse ndërtime nuk ka tash për tash, në qoftë se po flitet për lagjet qe janë në afërsi të Badovcit, jam për t'i ndaluar edhe ato. Këtë iniciativë e përshëndes, por po them që veprimet tona dhe vendimet të cilat merren në këtë kuvend, të kenë efekte ligjore, që me të vërtet të bëjmë zgjidhje e jo propagandë.

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit rreth çështjes së ndërtimit afër liqenit të Badovcit, sqarime shtesë dhanë edhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, dhe Ardi Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

**Kryesuesi i hodhi** në votim rekomandimet e propozuara dhe të harmonizuara nga përfaqësuesit e subjekteve politike.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 2 kundër, u miratuan rekomandimet e harmonizuara nga subjektet politike të Kuvendit të Komunës.**

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin, që Kuvendi i Komunës të marrë vendim që të pezullojë Planin zhvillimor komunal për zonat 1,2 dhe 3, për mbrojtjen në pjesën e Badovcit, deri në nxjerrjen e dokumenteve të reja të planifikimit në këtë zonë, Planin zhvillimor komunal, Hartën zonale dhe Planin e hollësishëm rregullues.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për pezullimin e Planit zhvillimor komunal për zonat 1,2 dhe 3, për mbrojtjen në pjesën e Badovcit, deri në nxjerrjen e dokumenteve të reja të planifikimit në këtë zonë, Planin zhvillimor komunal, Hartën zonale dhe Planin e hollësishëm rregullues.**

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

Faqe 5 nga 5

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**